



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 07/12/2016

RAPORT I MBAJTUR NË TAKIMIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE ME BANORËT
NJËSISË ADMINISTRATIVE BULGAREC

Morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, staf i bashkisë dhe banorë të njësisë administrative Bulgarec.

Takua banorët e Njësisë Administrative Bulgarec në datë 07/12/2016 për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve për vitin 2017 për t'ua përmirësuar jetesën në çdo fshat ku ata jetojnë. Një diskutim i cili u mbështet tek vlerësimet pozitive nga banorët për punët dhe investimet e kryera gjatë kësaj kohe si dhe kërkesat e nevojat e tyre prioritare në lidhje me përmirësimin e ndriçimit publik e furnizimit me ujë të pijshëm, vazhdimësi të punës për pastrimin dhe sistemimin e rrugëve në bllloqet e parcelave, sistemim të rrugëve hyrëse në fshatra, rikonstruksion dhe shtesë të shkollës 9 vjeçare në fshatin Lumalas.











